



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr. 746/Prot, datë 27.8 2025
5

MINISTRIA E FINANCEVE

Nr. 856/Prot, datë 27.8 2025
3

Udhëzim i Përbashkët

Nr. 5, datë 27.8 2025

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE
PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË
KULTURORE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 10 të nenit 29 të Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Ky Udhëzim përcakton tarifat për shërbimet e ofruara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i ndryshuar.
2. Tarifat përkatëse të aplikimit janë sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
3. Tarifat për shërbimet bëhen publike në faqen zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.
4. Të ardhurat nga tarifat e mbledhura, derdhen si më poshtë vijon:
 - a) 100% (njëqind për qind) në buxhetin e shtetit për të ardhurat nga shërbimet sipas pikave 1, 2 dhe 3 të shtojcës që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
 - b) 10% (dhjetë për qind) në buxhetin e shtetit dhe 90% (nëntëdhjetë për qind) në buxhetin e Institucionit për të ardhurat nga shërbimet sipas pikave 4, 5, 6, 7, 8, 9, dhe 10, të shtojcës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
5. Përfshihen nga pagesa e tarifave të gjitha organet publike dhe shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, të cilat janë në rolin e investitorit/zhvilluesit apo të objekteve publike.
6. Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifat, të cilat depozitohen për llogari të IKTK-së është Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe arkëtimi kryhet sipas autorizimit, të lëshuar për këtë qëllim pranë bankave të nivelit të dytë. Mandati i pagesës ngarkohet në sistemin elektronik e-Leje. Modeli i faturës miratohet me urdhër të drejtorit të



përgjithshëm të IKTK-së.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT**

Blendi Gonxhja



MINISTRI I FINANCAVE

Pëtr Malaj



Shtojcë nr. 1

1. **Tarifat për aplikim në Sportelin Unik të Sekretarinë Teknike të IKTK-së, për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) për lejet për ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale janë si vijon:**

Aplikimi për leje për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale	Vlera në lekë
Monument Kulture i Kategorisë së Parë;	10,000
Monument Kulture i Kategorisë së Dytë;	10,000
Brenda Kufirit Qendër Historike;	10,000
Brenda Kufirit Ansambël Historik Urban;	10,000
Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike	10,000
Brenda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit	10,000
Ndërhyrje në Vepra Arti	10,000
Shtyrje afati të punimeve dhe/ose ndryshim të pjesshem të projektit	10,000
Brenda Kufirit Park Arkeologjik	10,000
Brenda Kufirit Zonë me Potencial Arkeologjik	10,000
Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "A"	10,000
Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B"	10,000

2. **Tarifa për aplikim për Leje për Zhvillimet Transformuese në Territor (rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si dhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private do të llogaritet sipas përcaktimeve të VKM nr. 428, datë 26.06.2024, pika 4.** Tarifa për aplikim pranë KKTKM-së për leje zhvillimore është në vlerën 100 (njëqind) lekë për m², të sipërfaqes së pronës që do të zhvillohet.

3. **Tarifa për mbikqyrje arkeologjike në terren në masën 20,000 lekë/ditë.** Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimmarrjes së KKTKM-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga IKTK.

4. **Tarifa për vëzhgim intensiv arkeologjik do të llogaritet në bazë të sipërfaqes së një projekti të aplikuar si më poshtë vijon:**

Tarifa	Njësia	Vlera në lekë
Për projekt me sipërfaqe 0-1,000 m ² vëzhgim	1,000/m ²	50,000
Për projekt me sipërfaqe 1,001 – 5,000 m ² vëzhgim	5,000/m ²	150,000
Për projekt me sipërfaqe 05,001-25,000 m ² vëzhgim	25,000/m ²	300,000
Për projekt me sipërfaqe më të madhe se 25,000 m ² vëzhgim	25,001/m ²	500,000

5. **Tarifa për gjurmim arkeologjik në terren në masën 70,000 lekë/m³ gjurmimi.** Vëllimi i gjurmimit përcaktohet nga IKTK në bazë të projektit ndërtimor dhe nga sondazhet arkeologjike të kryera më parë në territorin objekt i projektit. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimmarrjes së KKTKM-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga IKTK.

6. **Tarifa për sondazh arkeologjik** në masën 70,000 lekë/m³ sondazhi. Vëllimi i gërmimit përcaktohet rast pas rasti nga IKTk në bazë të raportit të vazhimit arkeologjik. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimmarrjes së KKTKM-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga IKTk.

Mënyra e aplikimit do të jetë në varësi të fazave që do të nevojiten. Në rast se për një objekt do të nevojitet vetëm vëzhgim intensiv arkeologjik, do të aplikohet tarifa vetëm për këtë shërbim. Në rast se do të nevojiten të tre fazat, tarifa që do të aplikohet do të jetë shumë e të tre tarifave (vëzhgim, gërmim dhe sondazh).

7. **Tarifa për përgjigje nga Arkivi Teknik** për kërkesat nga personat privat në masën si më poshtë:

Shërbimi	Vlera në lekë
Një përgjigje shkresore nga Arkivi Teknik	2,000
Një përgjigje në formë digjitale nga Arkivi Teknik	1,500

8. **Tarifë për pajisje me kopje** një projekti, relacioni, dokumentacion tjetër teknik nga Arkivi Teknik i IKTk-së në në format A4 në masën si më poshtë:

Shërbimi	Vlera në lekë
Pajisje me një projekt/relacion teknik në A4 në formë shkresore	2,500
Pajisje me një projekt/relacion teknik në A4 në formë digjitale	2,000

9. **Tarifë për pajisje me kopje** një projekti, relacioni, dokumentacion tjetër teknik nga Arkivi Teknik i IKTk-së në format A3 në masën si më poshtë:

Shërbimi	Vlera në lekë
Pajisje me një projekt/relacion teknik në A3 në formë shkresore	2,700
Pajisje me një projekt/relacion teknik në A3 në formë digjitale	2,000

10. **Tarifë për mbikqyrje dhe kolaudim** të punimeve në restaurim do të llogaritet sipas përcaktimeve të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

